

# KIS Interpretimi 13

## ***Njësitë Ekonomike të Kontrolluara Bashkërisht— Kontributet jo Monetare nga Sipërmarrësit***

### Referencat

---

- SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*
- SNK 16 *Aktivitet Afatgjatë Materiale*
- SNK 18 *Të Ardhurat*
- SNK 31 *Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta*

### Çështje

---

- 1 SNK 31 par. 48 shprehet për kontributet dhe shitjet ndërmjet sipërmarrësit dhe sipërmarrjes së përbashkët si vijon: ‘Kur sipërmarrësi jep kontribute apo shet aktive të një sipërmarrjeje të përbashkët, njohja e pjesës së fitimit ose humbjes nga transaksioni i kryer tregon përmbajtjen e transaksionit’. Gjithashtu, SNK 31 paragrafi 24 shpreh se ‘njësia ekonomike e kontrolluar bashkërisht është një sipërmarrje e përbashkët që përmban themelimin e shoqërisë aksionere, ortakërisë ose njësie ekonomike të formave të tjera ku sipërmarrësi ka interesa’. Nuk ka udhëzime të lidhura drejtpërdrejt me njohjen e fitimit ose humbjeve neto që rrjedhin nga kontributi i aktiveve jomoneare tek njësitë e bashkëkontrolluara (‘JCE<sup>te</sup>/NBK’).
- 2 Kontributet në NBK janë transferta të aktiveve nga sipërmarrësit në këmbim të interesave të marra nga kapitali neto i NBK-ve. Këto kontribute mund të jenë të formave të ndryshme. Sipërmarrësit mund të derdhin kontributet e tyre njëherazi në kohën e themelimit të shoqërisë aksionere, ose më pas. Shuma që merr sipërmarrësi /sipërmarrësit në këmbim të aktiveve të kontribuara në NBK mund të shprehet në mjete monetare ose shuma të tjera të pavarura nga flukse të ardhshme të mjeteve monetare të NBK (‘shuma shtesë’).
- 3 Çështjet janë:
  - (a) kur pjesa përkatëse e fitimeve ose humbjeve neto që merret nga kontributi me aktiv jomonetar tek NBK-ja në këmbim të interesit nga kapitali neto i NBK-së, kjo duhet të njihet nga sipërmarrësi tek pasqyra e të ardhurave;
  - (b) si t’i kontabilizojë sipërmarrësi shumat/konsiderimet shtesë; dhe
  - (c) si të paraqitet humbja ose fitimi neto i përcaktuar në pasqyrën financiare të konsoliduar të sipërmarrësit.
- 4 Ky interpretim lidhet me kontabilizimin e kontributeve jomonetare të sipërmarrësit tek NBK-ja në këmbim të interesit nga kapitali neto në NBK që kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit neto, ose metodën e konsolidimit proporcional.

### Konsensusi

---

- 5 Gjatë zbatimit të paragrafit 48 të SNK 31 për kontributet jomonetare tek NBK në këmbim të interesit nga kapitali neto i NBK-së, sipërmarrësi duhet ta njohe pjesën e fitimit neto ose të humbjes për periudhën sipas anës përkatëse të pasqyrës financiare të ngarkueshme tek interesat të kapitalit neto të sipërmarrësve të tjerë, me përjashtim të rasteve kur:
  - (a) rreziqet domethënëse dhe përfitimet nga pronësia e aktivitetit (aktiveve) jomonetare të kontribuara nuk janë kaluar tek NBK; ose
  - (b) fitimi neto ose humbjet e kontributeve jomonetare nuk mund të maten në mënyrë të besueshme; ose
  - (c) transaksioni nga kontributi nuk ka përmbajtje tregtare, siç përkufizohet nga SNK 16.
 Nëse përjashtimet (a), (b) ose (c) vihen në jetë, fitimet neto / humbjet quhen të përcaktuara dhe rrjedhimisht, po të mos zbatohet paragrafi 6, nuk njihen si fitime/humbje.

- 6 Nëse sipërmarrësi merr aktive monetare ose jomonetare të tjera përveç marrjes së interesit nga kapitali neto i NBK-së, pjesa përkatëse e fitimit neto/humbjes nga transakioni do të njihet nga sipërmarrësi si fitim ose humbje.
- 7 Fitimet neto ose humbjet e parealizura nga kontributet e aktiveve jomonetare në NBK do të eliminohen kundrejt aktiveve bazë sipas metodës së konsolidimit proporcional, ose kundrejt investimit sipas metodës së kapitalit neto. Këto humbje ose fitime neto të parealizura nuk do të paraqiten as si fitime neto të shtyra, as si humbje në bilancin e konsoliduar të sipërmarrësit.

## **Data e rënies në konsensus**

---

Qershor 1998

## **Data e Hyrjes në Fuqi**

---

Ky Interpretim hyn në fuqi për periudhat financiare vjetore që fillojnë në datën 1 Janar 1999, dhe më pas. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Ndryshimet në politikat kontabël do të bëhen sipas përcaktimeve të dhëna në SNK 8.

- 14 Ndryshimet në kontabilizimin e transaksioneve të kontributit jomonetar sipas përcaktimit të paragrafit 5 zbatohen për transaksionet e ardhshme në mënyrë prospektive.
- 15 Njësitë ekonomike do t'i miratojnë ndryshimet e këtij Interpretimi nga SNK 16 për periudhat vjetore që prej datës 1 Janar 2005. Nëse njësitë ekonomike e miratojnë Standardin për periudha më të hershme, këto ndryshime do të zbatohen edhe për ato periudha.

